



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë - Albania,

Tel/Fax: 04 2268141; 042268142

Nr. 771/5 Prot.

Tiranë, më 21.03.2016

V E N D I M

Nr. 26, datë 21.03.2016

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me procesin e mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të zhvilluar në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vlorë,

Vërej se:

Në zbatim të Vendimit nr. 121, datë 05.11.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vlorë*", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen tematike në këtë subjekt.

Objekti i mbikëqyrjes është tematik dhe përfshin verifikimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve, të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me programin e mbikëqyrjes nr. 771/1 prot., datë 05.11.2015, të miratuar nga Komisioneri dhe njoftuar institucionit, me shkresën nr. 771/2 prot., datë 05.11.2015 "*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*".

Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 771/3 prot., datë 02.02.2016, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial që kanë pësuar njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, disa njësi të qeverisjes vendore, si bashki edhe komuna, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, janë bërë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Vlorë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, “Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”, pika 1, përcaktohet se bashkia është trashëgimtari ligjor i njërive të qeverisjes vendore që janë shkruarë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njërive të qeverisjes vendore që janë shkruarë. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, “Transferimi i personelit”, parashikohet se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njërive që janë shkruarë dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në rastin konkret, shtrirja territoriale e Bashkisë Vlorë, si organ i qeverisjes vendore, përfshin edhe njësi vendore të organizuara më parë si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, të tilla si Bashkia Oriku, Komuna Novoselë, Komuna Qendër dhe Komuna Shushicë, të cilat, në bazë të ligjit nr.30/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, aktualisht janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, është bërë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Vlorë.

Në këto rrethana të reja, të krijuara për shkak të riformatimit të njërive të qeverisjes vendore, ky raport me konkluzionet e tij, si dhe vendimi përkatës i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për miratimin e raportit përfundimtar dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar situatën, do t'i drejtohen për zbatim njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, si institucioni i ngarkuar me ligj për administrimin e shërbimit civil në këtë rast. Ndryshimet që kanë ndodhur për shkak të riorganizimit të njërive të qeverisjes vendore, janë pasqyruar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për të paraqitur observacionet përkatëse, rezulton se, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe drejtori përkatës, me shkresën nr. 803/1 prot., datë 09.02.2016, “Informacion mbi projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Vlorë”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 771/4 prot., datë 03.03.2016.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse rezulton se, subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakord me rekomandimet e nxjerra nga grupi i punës, por ka pasqyruar disa sqarime në lidhje me gjetjet në projektraport, të cilat janë trajtuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar, në kapitujt përkatës.

Për sa më sipër, e vlerësoj si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me projektraportin dhe çmuj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, në përfundim të këtij procesi, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Vlorë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e shërbimit civil duke zbatuar detyrat si më poshtë:
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, që të rregullojë pasojat lidhur me punonjësit të cilët nuk përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, për shkak se nuk plotësojnë nivelin arsimor, si më poshtë:
 - ***** , në pozicionin e punës *“Specialist Infrastruktura”*;
 - ***** , në pozicionin e punës *“Specialist Infrastruktura”*;
 - ***** , në pozicionin e punës *“Inspektor Tatimesh”*;
 - ***** , në pozicionin e punës *“Përgjegjës i Zyrës së Financës”*;
 - ***** , në pozicionin e punës *“Specialist i Ndihmës Ekonomike”*;
 - ***** , në pozicionin e punës *“Përgjegjës Tatim Taksash”*.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë situatën, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil dhe të përfundimit të marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se, ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
 - Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t`u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Vlorë.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, të nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit përkatësisht:

- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”.
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist IT” ;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist i Nivelit të Lartë për Tregjet”
(pavarësisht se aktualisht, ai punon në një pozicion pune që nuk është pjesë e shërbimit civil).

4. Të plotësohen dosjet e personelit për këta punonjës konkretisht, ***** , ***** , ***** dhe të vijojë procesi i deklaramit të statusit të tyre të punësimit.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
6. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Vlorë dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA